



01 Nr. 574/24 Dt. 23.09.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për lejimin e furnizimit me dru për ngrohje për familjet e dëshmorëve, invalidët e luftës së UÇK-së dhe për familjet skamnore të Komunës së Prizrenit, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për furnizim me gjithsej 2472 m³ dru për ngrohje, sikurse në vijim:
 - 1.1. Për familjet e dëshmorëve-213 familje nga 3 m³, dru për ngrohje;
 - 1.2. Për invalidët e luftës së UÇK-së -211 familje me nga 3 m³, dru për ngrohje;
 - 1.3. Për familjet skamnore (raste sociale, grupe të marginalizuara dhe ne vështirësi ekonomike) të Komunës së Prizrenit, (400 familje) për secilën familje nga 3 m³, dru për ngrohje.
2. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor- mallra dhe shërbime të Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.
3. Obligohet Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Sektorit të Prokurimit,
 - Arkivës së Kryetarit.

